

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919543/video-fjalimet-ne-okb-maliqi-rama-foli-per-veten-e-tij-kurti-kishte-ne-fokus-ceshtjet-e-kosoves/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 17:22:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 16:59:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	252a8bbbc59721d64f1ed2ad49b35e0443b310623d3b79a3d217eb11a68ed319
TEKSTI	c143c155c8c4d0e99fc134f8c89d9da6e31725ecea56702273666a842409da0d
PAMJA	e06102ce30e8d4cbc1907678058115ed5184774b94680790800defd3d113eb6a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	91f6c7bd0723abeb8aa9085b992e49a9c87a457fb041f7e96815ad09cc37b2e2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	622c8162b2af4b3a4f32b10517ab558346d08e6b143a7ec62e7fa674754e4065
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/91f6c7bd0723abeb8aa9085b992e49a9c87a457fb041f7e96815ad09cc37b2e2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




ÇIM PEKA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat




'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?



Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin



Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së



'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht



VIDEO/ Fjalimet në OKB, Maliqi: Rama foli për veten e tij, Kurti kishte në fokus çështjet e Kosovës

18:59, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gazetari shqiptar Nefail Maliqi, i cili jeton dhe punon në Gjenevë, ishte i ftuar në emisionin 'Syri i Botës' në SYRI TV, me moderatoren Dori Daka, ku foli për zhvillimet në Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe paraqitjen e liderëve shqiptarë në Nju Jork.

Maliqi u ndal veçanërisht te kryeministri shqiptar Edi Rama dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke vënë në dukje pranimin e tyre në aktivitetet e OKB-së dhe në takimet në margjinat e Asamblesë.

Sipas gazetarit, shqiptarët këtë vit kanë pasur një prani të dukshme në OKB, jo vetëm përmes fjalimeve, por edhe përmes takimeve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Nju Jork.

'Fillimisht do të ndalem tek fjalimi i presidentit amerikan Trump, i cili bëri bujë të madhe në mediat botërore dhe zgjoi interesim të madh, sidomos për ne në Ballkan, i cili duke numëruar tetë konfliktet si sukses i tij që ju kishte dhënë fund luftimeve, përmendi këtu edhe atë mes Kosovës dhe Serbisë. Në këtë fjalim Trump ka falënderuar dhe ka marrë falënderime siç tha ai, nga Kosova dhe Shqipëria.

Po, prandaj edhe këtë vit, pas dy vitesh, një tjetër çështje e rëndësishme këtu në OKB do të jetë edhe ardhmja e OKB-së dhe zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm të ardhshëm, pasi mandati i António Guterres përfundon më 31 dhjetor 2026.

Gjatë sesionit të 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në New York do të zhvillohet edhe një betejë diplomatike për atë se kush do të jetë numri një i OKB-së nga 1 janari i vitit të ardhshëm, domethënë në vitin 2027. Janë tetë kandidatë, prej tyre gjysma janë gra. Kosta Rika është njëra, pastaj Guajana, Argjentina, Uganda, Senegali, Ekuadori, Kili... por nuk ka asnjë nga Ballkani apo nga Evropa.

Sidoqoftë, një tjetër element historik e bën këtë garë të veçantë. Në mesin e... siç e dini, OKB-ja funksionon që 80 vite, një vit historik si vjet, është në OKB që asnjë grua deri tani nuk e ka mbajtur postin e Sekretarit të Përgjithshëm. Merre me mend, që 80 vite, gati një shekull, në krye të kësaj organizate, edhe pse OKB-ja

net vazhdimisht, kurdet diskriminimin te rritave, te gruas, pastaj per respektimin e te drejtave te vajzave, grave, per t'i dhene hapesire ne institucionet e vendeve te larmishme ne botë, kurse ajo vetë nuk e bën.

Kjo i bie, bëj çfarë të them unë, e mos bëj si unë. Dhe kjo na kujton edhe bordin e paqes të Donald Trump të iniciuar vitin e kaluar në Davos, që flitej se mund të jetë një institucion ndërkombëtar paralel me OKB-në. Kështu që më duket se OKB-ja është lodhur një çikë.

E thashë këtë sepse kur unë isha gazetari i parë shqiptar në OKB para 30 vitesh, në botë kishim vetëm pesë-gjashtë konflikte. Kurse sot kemi mbi 120 sosh. Atëherë shtrihet pyetja, cili është roli i OKB-së, t'i zvogëlojë konfliktet apo t'i rrisë ato? Kështu që mendoj se OKB të mos mbetet si mesazh një organizatë që të numërojë vetëm diskriminimin dhe viktimat, por të parandalojë ato duke ndërmarrë masa preventive, qoftë me dialog apo me forcë.

Rasti në Bosnje për shembull, OKB-ja në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar të dështuar, ju kujtohet kur i lidhën për shtylla telefonike kaskat blu, dhe shkaktuan mbi 100 mijë viktima në Bosnje, në Srebrenicë masakrën, gjenocidin e të tjera. Dhe kështu që, edhe në Kosovë, kur ishte puna me intervenu, Këshilli i Sigurimit nuk i dha vizën.

Por NATO, Shtetet e Bashkuara, pa vizën, domethënë pa asnjë lejen e OKB-së e bombarduan Serbinë për të ndalur një katastrofë humanitare, për të ndalur gjenocidin, spastrimin etnik në Kosovë, sepse ashtu-kështu bëri spastrim etnik duke larguar nga Kosova 850 mijë shqiptarë. Kështu që mendoj se, sado kudo ato u bënë të gjitha pa vizën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Dhe këtu shtrihet pyetja, ku është edhe roli i sotëm i kësaj organizate ndërkombëtare.

Mund të them se shqiptarët sivjet kanë dominuar në OKB. Domethënë në Asamblesë e Përgjithshme, qoftë me fjalime, qoftë në margjinat e OKB-së. Ka pasur një pesë-gjashtë fronte.

Përveç kryeministrit shqiptar Edi Rama, ishte Albin Kurti, ishte pastaj në një anë kishim zonjën Vjosa Osmani në New York, mos ta harrojmë ish-presidentin, pastaj ishte edhe Behgjet Pacolli në anën tjetër kishte takime, ishte dhe një shqiptar nga Maqedonia.

Kishte dhe protesta, që Edi Rama u prit me fishkëllima, i bërtitën mafioz, kriminel, dhe e gjuajtën me vezë. E kështu me radhë. Por, fillojmë për shembull, sipas njoftimeve tona nga OKB-ja, kryeministri Edi Rama, sesionit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së i është drejtuar të premten e kaluar, i cili foli kryesisht për zhvillimet në Shqipëri, sukseset e tij, afrimi i Shqipërisë drejt BE-së, por siç e dëgjua zoti nuk e kërkoi asnjë fjalë edhe një shtetësi, siç ishte kërkuar vitin e kaluar.

Pas kësaj, mund të themi se në OKB foli ditën e mërkurë që lamë pas edhe presidenti serb Aleksandar Vuçiç. I cili, pur çudi, fjalimin e tij që pritej nga të gjithë, se ai do të flasë edhe për vrasjen e gjashtëmbëdhjetë shtatorit të Banjskës.

Për atë ish-kriminelin e tij që e strehoi, ai asnjë fjalë nuk e tha. Ndryshe, në fjalimin e tij Vuçiç u fokusua kryesisht te Kosova, Rezoluta 1244, integriteti territorial i Serbisë, marrëveshja e Brukselit dhe kritikën ndaj sistemit ndërkombëtar. Madje, presidenti serb tërthorazi ka kërcënuar Kosovën në OKB. Ai tha se ne do të mbrojmë integritetin territorial të Serbisë dhe kartën e OKB-së. Çfarë do të thotë kjo? Por Vuçiç harroi se Gjykata Ndërkombëtare e OKB-së në Hagë, në vitin 2010, tha se pavarësia e Kosovës nuk shkel të drejtën ndërkombëtare. , tha gazetari Nefail Maliqi në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Protesta e 120-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë nga Sheshi Skënderbej drejt Kryeministrit



Droga po shkon tek fëmijët tanë!



VIDEO/ Brahaj: OKB-ja u kthye në skenë shou, liderët luajtën secili për vete, problemet mbetën aty

Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet

Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



'Në emër të Këshillit Bashkiak, por firmat janë të PS' / Alimehmeti: Rama e futi Veliajn në burg, Rama e mban



Rama anuloi konferencën, Noka: Duhej të jepte llogari për emërimet e tij, iu tremb pyetjeve për SHISH-in dhe Vlora Hysenin



SYRI TV/ Skandali i SHISH, Rama largon përgjegjësinë nga vetja: Përgjegjësia është individuale



VIDEO/ Mal Berisha-Ramës: Të quash Biden tradhtar është fyese, ai është një nga mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës



17 firmat brenda ditës dhe kontrata pa fonde/ Malltezi: Kush ia vuri kufirin SPAK-ut te inceneratorët?



VIDEO/ Abilekaj: Rama shmangu gazetarët që të gënjente, monologu mënyra për të mos iu përgjigjur pyetjeve



Shkullaku ironizon Ramën: Pas 28 vitesh në pushtet, paska dalë më i varfër se sa ka hyrë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.